



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Received Primit / Received	22.12.2023	3	viti / god year
Organ / Shërbimi Org / Unit	7599/2023	1/8	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.1322/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1321/2023, të datës 24.10.2023, të parashtruar nga ankuesi nga Peja dhe ankesën A.nr.1322/2023 të datës 24.10.2023 të parashtruar nga ankuesi të bashkuara në ankesën A.nr. 1322/2023, kundër organit të punësimit: Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike „kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.12.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr. 1322/2023, e parashtruar nga ankuesit Endrit Peli dhe

II. Mbetet në fuqi Renditja përfundimtare me numër protokolli 265, e datës 18.10.2023, e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Korrektues të Kosovës, lidhur me rezultatet e kandidatëve për testin me shkrim dhe intervistën më gojë, për pozitën e punës “Kadet për Zyrtarë Korrektues” në Qendrën Korrektuese në Dubravë.

A r s y e t i m

Ankuesit (më tej vetëm ankuesit) me datë 24.10.2023, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër listës përfundimtare për përzgjedhjen e kandidatëve lidhur me pozitën për zyrtar korrektues në Qendrën Korrektuese në Dubravë, me pretendimet ankimore së Komisioni Përzgjedhës nuk ka bërë vlerësim të drejtë në intervistën me gojë dhe se i njëjti nuk ka bërë vlerësim meritore. Tutje, shtojnë se kandidati i listuar me numër aplikacioni 91, si kandidati me më së shumti pikë të fituara, ka aplikuar në katër qendra korrektuese dhe se përfundimisht është renditur në Qendrën Korrektuese në Dubravë, gjë që sipas pretendimeve të tyre ka qenë shkelje për të gjithë. Kërkojnë që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të vendos në favor të ankueseve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 25.10.2023 dhe 06.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesat e ankuesve tek Shërbimi Korrektues i Kosovës,

ndërsa, kjo e fundit, më datë 03.11.2023 dhe 09.11.2023, ka përcjellë përgjigjen në ankesat e ankuesve së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Duke qenë se ankesat bazohen në gjendje të njëjtë faktike dhe bazë juridike, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër të protokollit 7215/2023 të datës 04.12.2023, ka bërë bashkimin e ankesave A.nr.1321/2023, të datës 24.10.2023, të parashtruar nga ankuesi dhe ankesës A.nr.1322/2023 të datës 24.10.2023 të parashtruar nga ankuesi nga Peja, ashtu që ankesat e bashkuara kanë marrë numrin e ankesës A.nr.1322/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptime të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6665/2023 të datës 24.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Renditja përfundimtare e rezultateve të kandidatëve për kadet zyrtar korrektues me numër protokollit 265 i datës 18.10.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve që kanë kaluar testin me shkrim për pozitën zyrtar korrektues me numër protokollit 241 i datës 21.09.2023; Letërnjoftim i E.P.; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 06.11.2023; Përgjigje në ankesë e datës 10.11.2023; Vendim për emërim të komisionit përzgjedhës me numër protokollit 1084 i datës 21.08.2023; Konkurs për pozitën Kadet për zyrtar korrektues 70 vende pune me numër protokollit 872 i datës 30.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 03.11.2023; Lista preliminare e kandidatëve që plotësojnë kriteret e konkursit për t'ju nënshtruar testit me shkrim në SHKK, me numër protokollit 208 të datës 28.08.2023; Rezultatet preliminare të vlerësimit të intervistës me gojë në SHKK me numër protokollit 261 të datës 12.10.2023; Rezultatet preliminare të kandidatëve që ju kanë nënshtruar testit me shkrim për kadet zyrtar korrektues me numër protokollit 229 i datës 13.09.2023; Kërkesa për punësim e V.B. për pozitën zyrtar korrektues i datës 07.07.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr. 125; Kërkesa për punësim e Sh.H. për pozitën zyrtar korrektues i datës 01.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.96; Kërkesa për punësim e I.B. për pozitën zyrtar korrektues i datës 10.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.179; Kërkesa për punësim e J.B. për pozitën zyrtar korrektues i datës 04.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.171; Kërkesa për punësim e A.H. për pozitën zyrtar korrektues i datës 14.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.236; Kërkesa për punësim e G.H. për pozitën zyrtar korrektues i datës 10.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.162; Kërkesa për punësim e K.G. për pozitën zyrtar korrektues i datës 11.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.197; Kërkesa për punësim e A.H. për pozitën zyrtar korrektues i datës 10.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Kërkesa për punësim e E.N. për pozitën zyrtar korrektues i datës 09.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.178; Kërkesa për punësim e E.B. për pozitën zyrtar korrektues E datës 14.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.288; Kërkesa për punësim e T.P. për pozitën zyrtar korrektues i datës 14.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.268; Kërkesa për punësim e Q.Sh. për pozitën zyrtar korrektues i datës 08.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.149; Kërkesa për punësim e A.T. për pozitën zyrtar korrektues i datës 07.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.137; Kërkesa për punësim e F.B. për pozitën zyrtar korrektues i datës 01.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.91; CV-ja e F.B.; Certifikatë mbi dënimet penale e F.B. i datës 30.07.2023; Letërnjoftim i F.B.; Diplomë e shkollës së mesme me numër protokollit 02/307 e F.B. i datës 16.09.2014; Kërkesa për punësim e E.P. për pozitën zyrtar korrektues i datës 11.08.2023, së

bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.305; Kërkesa për punësim e A.B. për pozitën zyrtar korrektues i datës 01.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.85; Kërkesa për punësim e B.C. për pozitën zyrtar korrektues i datës 07.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.139; Kërkesa për punësim e D.M. për pozitën zyrtar korrektues i datës 07.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.140; Kërkesa për punësim e L.E. për pozitën zyrtar korrektues i datës 04.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.124; Kërkesa për punësim e A.O. për pozitën zyrtar korrektues i datës 11.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.220; Kërkesa për punësim e K.M. për pozitën zyrtar korrektues i datës 07.08.2023, së bashku me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me nr.128; Akt Emërim i A.K. i datës 10.07.2023; Akt Emërim i R.H. i datës 24.03.2023; Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar e I.I. i datës 02.07.2018; Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar e F.S. i datës 06.09.2018; Akt Emërim i V.N. I datës 06.05.2019; Vendim i SHKK me numër protokolli 263/2 i datës 16.10.2023; Kërkesë e F.B. me numër protokolli 263 i datës 16.10.2023; Lista e kandidatëve që kanë kaluar testin e shkathtësive fizike për pozitën zyrtar korrektues me numër protokolli 251 i datës 28.09.2023; Renditja e kandidatëve që janë nënshtruar testit të shkathtësive fizike për pozitën kadet zyrtar korrektues me numër protokolli 1203 i datës 23.09.2023; Aplikacionet e aplikuesve; E-mail nga A.K. për F.G. i datës 21.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr. 149 i Q.H. i datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.137 i A.T. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.139 i B.C. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.96 i Sh.H. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.305 i E.P. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.124 i L.E. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.268 i T.P. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.201 i A.H. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.162 i G.H. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.125 i V.B. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.86, 89, 90 dhe 91 i F.B. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.179 i I.B. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.197 i K.G. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.178 i E.N. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.288 i E.B. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.140 i D.M. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.171 i J.B. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.128 i K.M. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.236 i A.H. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.220 i A.O. I datës 09.09.2023; Testi me shkrim kadet për zyrtar korrektues me nr.85 i A.B. I datës 09.09.2023; Vendimin me numër protokolli 7215/2023 të datës 04.12.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit Vendimin me numër protokolli 7226/2023 të datës 05.12.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit si dhe Vendimin me numër të protokollit 7559/2023 të datës 19.12.2023 lidhur me bashkimin e ankesave të ankuesve.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesve, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 30.06.2023 ka shpall Konkursin me numër protokolli 872, për pozitën "Kadet për Zyrtar Korrektues" shtatëdhjetë (70) pozita dhe atë për: Qendrën Korrektuese në Dubravë sipas Referencës MD/SHKK/12/30.06.2023, njëzet (20) pozita; Burgun e Sigurisë së Lartë sipas Referencës MD/SHKK/13/30.06.2023, tetëmbëdhjetë (18) pozita; Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë sipas Referencës MD/SHKK/ 14/30.06.2023, tetëmbëdhjetë

(18) pozita si dhe Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë sipas Referencës MD/SHKK/15/30.06.2023, katërbëdhjetë (14) pozita,

Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 31.07.2023 deri më 14.08.2023, e në të cilin konkurs kanë aplikuar edhe ankuesit, rrjedhimsht të njëjtit kanë aplikuar për Qendrën e Paraburgimit në Dubravë, duke u përfshirë në fazën e vlerësimit të testit me shkrim dhe intervistës më gojë, mirëpo që sipas listës së renditjes përfundimtare të datës 18.10.2023, nuk kanë arritur të përzgjidhen si kandidat të suksesshëm.

Të pakënaqur me listën përfundimtare për përzgjedhjen e kandidatëve fitues lidhur me pozitën përkatëse, ankuesit më datë 24.10.2023, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Komisioni Përzgjedhës nuk ka bërë vlerësim të drejtë në intervistën me gojë dhe se i njëjti nuk ka bërë vlerësim meritore. Tutje, shtojnë se kandidati i listuar me numër aplikacioni 91, si kandidati me më së shumti pikë të fituara, ka aplikuar në katër qendra korrektuese dhe se përfundimisht është renditur në Qendrën Korrektuese në Dubravë, gjë që sipas pretendimeve të tyre ka qenë shkelje për të gjithë. Kërkojnë që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të vendos në favor të ankueseve.

Kolegji i Këshillit, në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, ndërlidhur me plotësimin e kërkesave të konkursit, nga kandidatët në procedurë, ka analizuar konkursin në fjalë dhe si rrjedhojë ka gjetur se si kriteret për këtë pozitë të punës janë përcaktuar:

- të jetë jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik;
- të ketë përfunduar shkollimin e mesëm, përkatësisht të mesëm të lartë;
- të jetë në gjendje të mirë psiko-fizike;
- të jetë i moshës tetëmbëdhjetë (18) deri në arritjen e moshës tridhjetë (30) vjet;
- të mos posedoj në vend të dukshëm tatuazh (fytyrë, qafë, duar).

Ndërsa, lidhur me dëshmitë që kandidatët duhet të dorëzojnë me rastin e aplikimit, është specifikuar:

- Formulari i aplikimit;
- Kopja e diplomës për arsimin e mesëm të lartë ose certifikata, ndërsa për kandidatët që kanë kryer shkollimin jashtë vendit, kopja e diplomës e notifikuar;
- CV-në;
- Vërtetimin nga gjykata që nuk është nën hetime dhe
- Kopjen e letërnjoftimit apo pasaportës.

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore i 'u referua nenit 4 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë (ligj ky i aplikueshëm në kohën e shpalljes dhe zhvillimit të terë kësaj procedure të rekrutimit) me të cilin është përcaktuar se: *1. Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë...*" dhe si rrjedhojë konstatoi se nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, resektivisht të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civilë si dhe ligjeve të veçanta lidhur me elementet e marrëdhënies së punës që kanë të bëjnë me: *1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve.* Nderlidhur me këtë, Kolegji i Këshillit analizoj edhe dispozitat e ligjit të veçantë përkatësisht Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës më theks: "*Neni 38.1. Konkursi për punësim për pozitën kadet për zyrtar korrektues në Shërbimin Korrektues të Kosovës*

bëhet përmes shpalljes publike në platformën shtetërore të punësimit dhe në ëeb faqen zyrtare të SHKK-së, jo më vonë se pesë (5) ditë pas vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm dhe i njëjti shpallet në faqen zyrtare të SHKK në gjuhët zyrtare në pajtim me ligjin për gjuhët. 2. Shpallja e konkursit për punësim përmbajë të dhënat si në vijim: 2.1. emri i institucionit; 2.2. pozita dhe përshkrimi i vendit të punës si dhe numri i referencës; 2.3. kriteret për aplikim-pjesëmarrje në procesin e rekrutimit; 2.4. koeficienti\grada e pagës; 2.5. kualifikimet e nevojshme arsimore; 2.6. moshën; 2.7. kohëzgjatjen e emërimit, si dhe kohëzgjatja e periudhës provuese; 2.8. dokumentacioni i nevojshëm për aplikim; 2.9. njoftime për testet të cilave do t'u nënshtrohet kandidati, si dhe broshura informuese për të gjitha fazat e testimit të kandidatëve; 2.10. mënyrën, vendin dhe adresën e saktë ku merren dhe dorëzohen aplikacionet; 2.11. datën e mbylljes së konkurrimit e cila duhet të jetë së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit; 2.12. njoftimin për mos pranimin e aplikacioneve pas afatit si dhe njoftimin për refuzimin e aplikacionit në rast se janë të mangëta; 2.13. konkursi publik përmban klauzolën "Shërbimi Korrektues i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitet në Kosovë"; 2.14. vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të njoftohen përmes ëebfaqes zyrtare të SHKK-së. **Neni 39** Kushtet e veçanta për rekrutim për pozitën kadet për zyrtarë korrektues 1. Kandidatët që aplikojnë për zyrtarë korrektues përpos kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për zyrtarë publikë, duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte e veçanta si në vijim: 1.1. të jetë i moshës tetëmbëdhjetë (18) deri në arritjen e moshës tridhjetë (30) vjet; 1.2. të jete në gjendje të mirë psiko-fizike; 1.3. të mos posedojë në vend të dukshëm tatuazh në fytyrë, qafë apo duar; 1.4. të mos jetë nën hetime për vepër penale. 2. Dokumentacioni për aplikim duhet të përmbajë: 2.1. formularin e aplikimit; 2.2. kopjen e diplomës për arsimin e mesëm, përkatësisht të mesëm të lartë ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit, kopja e diplomës e nostrifikuar; 2.3. CV-në; 2.4. vërtetimin nga organi kompetent që nuk është nën hetime; 2.5. kopjen e letërnjoftimit apo pasaportës. **Neni 40** Pranimi i aplikacioneve 1. Aplikacionet e kandidatëve pranohen dhe regjistrohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore. 2. Pas mbylljes së konkursit por jo më vonë se pesë (5) ditë pune, Njësia e Burimeve Njerëzore përgatitë listën e aplikantëve dhe të njëjtën së bashku me dosjet e kandidatëve ia dorëzon Kryesuesit të Komisionit përzgjedhës,.... **Neni 42** Procedura e testimit 1. Kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs, i nënshtrohen procedurave të testimit sipas radhitjes në vijim: 1.1. testi me shkrim; 1.2. testimi i shkathtësive fizike; 1.3. intervista me gojë, si dhe 1.4. testi shëndetësor. 2. Kandidati i cili dështon në njërin nga fazat e përzgjedhjes nuk ka të drejtë të vazhdojë në fazat tjera të procesit të rekrutimit. **Neni 43** Testimi me shkrim 1. Testi me shkrim përpilohet në gjuhët zyrtare dhe përbëhet nga pesëdhjetë (50) pyetje. Secila përgjigje e saktë ka vlerën e dy (2) poenëve dhe testi duhet të vlerësojë njohuritë në këto fusha: 1.1. katër dhjetë për qind (40%) njohuri të përgjithshme; 1.2. tridhjetë për qind (30%) njohuri për vendin e punës, si dhe 1.3. tridhjetë për qind (30 %) matematikë dhe gjuhë e letërsi. 2. Rezultati minimal i kërkuar për të kaluar me sukses testin është shtatëdhjetë (70) poenë të testit. 3. Koha e testimit zgjatë një (1) orë e tridhjetë (30) minuta. **Neni 44** Testimi i shkathtësive fizike 1. Standardet e testimit të shkathtësive fizike duhet të jenë të përshkruara në formularin, respektivisht në broshurën e shkathtësive fizike. 2. Gjatë procesit të testimit të shkathtësive fizike, përveç komisionit përzgjedhës duhet të jetë prezent edhe personeli mjekësor. 3. Nëse kandidati deklaron se është në gjendje të mirë shëndetësore dhe është i gatshëm t'i nënshtrohet testit të shkathtësive fizike, nga ai do të kërkohet që ta plotësojë dhe nënshkruajë formularin i cili SHKK-në e liron nga përgjegjësia dhe dëmshpërblimi, nëse atij gjatë këtij procesi i shkaktohet ndonjë problem shëndetësor apo lëndim fizik. 4. Vlerësimi i rezultatit të testit fizik bëhet në tri (3) elemente si: vrapim, pompa dhe barkore. Nëse kandidati nuk arrin të kalojë me sukses njërin nga këto elemente konsiderohet se ka dështuar.. **Neni 45** Intervista me gojë 1. Me rastin e intervistimit me gojë, kandidati vlerësohet për mënyrën e paraqitjes dhe prezantimit, aftësisë komunikuese, njohurive të përgjithshme, aftësisë për të analizuar, vendimmarrja, motivimi, përkushtimi dhe vetëbesimi. 2. Kandidati duhet të arrijë së paku një rezultat prej gjashtëdhjetë (60) nga njëqind (100) poenët e mundshme për të vazhduar më tutje me procesin e rekrutimit.... **Neni 47** Rezultatet e kërkuara për emërim Kandidati i suksesshëm konsiderohet ai i cili në testin me shkrim dhe intervistën me

gojë ka arritur të grumbullojë me së shumti poenë por jo më pak se gjashtëdhjetë e pesë për qind (65 %) të maksimumit të pikëve të caktuara, me kusht të ketë kaluar testin e vlerësimit shëndetësor

Për më tepër, Kolegji mori parasysh edhe dispozitat ligjore të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimin e së Kaluarës së Tyre, Periudhën Provuese dhe Promovimin, përkatësisht nenin 5 dhe 6 sipas të cilëve përcaktohet se: **Neni 5:** "Gradën kadet korrektues e merr kandidati i cili ka përfunduar me sukses procedurat e rekrutimit dhe ka nënshkruar kontratën për themelimin e marrëdhënies së punës si kadet korrektues me Shërbimin Korrektues të Kosovës", **Neni 6:** "Gradën I e merr kandidati i cili ka përfunduar me sukses trajnimin bazik në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe ka nënshkruar kontratën për themelimin e marrëdhënies së punës si zyrtar korrektues me Shërbimin Korrektues të Kosovës".

Andaj, referuar kuadrit ligjor si më lartë, si dhe bazuar në autorizimet kushtetuese dhe ligjore lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, Kolegji ka shqyrtuar respektimin e dispozitave procedurale dhe materiale nga organi i punësimit lidhur me këtë proces të rekrutimit, dhe si rrjedhojë i njëjti nuk ka konstatuar ndonjë shkelje esenciale procedurale, të cilat do të bënin të pa vlefshme juridikisht këtë procedurë të pranimit. Gjegjësisht, në kuptim të plotësisht të kriterëve të përcaktuara me konkurs nga ana e kandidatëve të përzgjedhur në Qendrën Korrektuese në Dubravë, Kolegji i Këshillit nga analizimi i dosjeve personale, ka konstatuar se kandidatët fitues të përzgjedhur sipas listës përfundimtare me numër protokolli 265, të datës 18.10.2023, lidhur me pozitën "Kadet për Zyrtar Korrektues", në Qendrën Korrektuese në Dubravë, kanë plotësuar kriteret e konkursit dhe se të njëjtit bazuar në vlerësimet nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, kanë arritur të vlerësohen si kandidatët me më së shumti pikë të fituara dhe atë: kandidati [] me numrin rendor 01, e sipas numrit të aplikacionit 91 ka grumbulluar gjithsej 89.3 pikë të fituara, kandidati [] me numrin rendor 2 e sipas numrit të aplikacionit 201, ka grumbulluar gjithsej 89.2 pikë të fituara, kandidati [] me numrin rendor 03, e sipas numrit të aplikacionit 197 ka grumbulluar gjithsej 85.9 pikë të fituara, kandidati [] me numrin rendor 04, e sipas numrit të aplikacionit 162, ka grumbulluar gjithsej 85.65 pikë të fituara, kandidati [] me numrin rendor 05, e sipas numrit të aplikacionit 23, ka grumbulluar gjithsej 84.9 pikë të fituara, kandidati [] me numrin rendor 06, e sipas numrit të aplikacionit 171, ka grumbulluar gjithsej 84.5 pikë të fituara, kandidati [] me numrin rendor 07 e sipas numrit të aplikacionit 179 ka grumbulluar gjithsej 84.3 pikë të fituara, kandidati [] me numrin rendor 08, e sipas numrit të aplikacionit 96, ka grumbulluar gjithsej 83.2 pikë të fituara, kandidati [] me numrin rendor 09, e sipas numrit të aplikacionit 125, ka grumbulluar gjithsej 83.2 pikë të fituara, kandidatja [] me numrin rendor 10, e sipas numrit të aplikacionit 268, ka grumbulluar gjithsej 83.05 pikë të fituara, kandidati [] me numrin rendor 11, e sipas numrit të aplikacionit 288, ka grumbulluar gjithsej 81.5 pikë të fituara, kandidati [] me numrin rendor 12, e sipas numrit të aplikacionit 178, ka grumbulluar gjithsej 81.1 pikë të fituara, kandidati [] me numrin rendor 13, e sipas numrit të aplikacionit 137, ka grumbulluar gjithsej 80.3 pikë të fituara, kandidati [] me numrin rendor 14, e sipas numrit të aplikacionit 149, ka grumbulluar gjithsej 80.2 pikë të fituara, kandidati [] me numrin rendor 15, e sipas numrit të aplikacionit 128, ka grumbulluar gjithsej 79.85 pikë të fituara, kandidati [] me numrin rendor 16, e sipas numrit të aplikacionit 220, ka grumbulluar gjithsej 79.7 pikë të fituara, kandidati [] me numrin rendor 17, e sipas numrit të aplikacionit 124, ka grumbulluar gjithsej 79.6 pikë të fituara, kandidatja [] me numrin rendor 18, e sipas numrit të aplikacionit 140, ka grumbulluar gjithsej 78.7 pikë të fituara, kandidatja [] me numrin rendor 19, e sipas numrit të aplikacionit 85, ka grumbulluar gjithsej 78.5 pikë të fituara dhe kandidati [] me numrin rendor 20, e sipas numrit të aplikacionit 139, ka grumbulluar gjithsej 78.5 pikë të fituara

Referuar pretendimeve ankimore të ankuesve se kandidati me numrin rendor 91 i listuar si kandidati me numrin maksimal të pikëve ka aplikuar në katër (4) qendrat dhe se përfundimisht është renditur në Qendrën


Korrektuese në Dubravë ka lenë me nënkuptua se ka pasur manipulime, Kolegji pas analizimit të shkresave të lëndës ka gjetur se kandidati ka aplikuar në konkursin e lartcekur dhe atë në Burgun e Sigurisë së Lartë sipas aplikacionit me numër 90, në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë sipas aplikacionit me numër 89, në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, sipas aplikacionit me numër 86 si në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë sipas aplikacionit me numër 91, ku i njëjti në bazë të shkresave të lëndës ka arritur të grumbulloj pikët e nevojshme par përzgjedhje në Qendrat Korrektuese në Dubravë, Prishtinë, dhe Mitrovicë,, mirëpo, bazuar në përzgjedhjen e tij me shkrim sipas shkresës me numër protokolli 263 të datës 16.10.2023, kandidati F. B është përcaktuar për përzgjedhje në Qendrën Korrektuese në Dubravë, kërkesë kjo e aprovuar nga Kryesuesi i Komisionit Përzgjedhës, me Vendimin Nr.263/2 të datës 16.10.2023, pasi që kandidati në fjalë është vlerësuar si kandidati me vlerësim të gjithsej 89.3, në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Andaj, mbi këtë bazë dhe nisur nga fakti se me asnjë dispozitë ligjore të ligjit të vëçantë, nuk përcaktohet detyrimi se kandidatët kanë të drejtë aplikimi vetëm në një Qendër Korrektuese, Kolegji vleron se pretendimi ankimor si më lartë është i papabuar.

Për sa më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se procedura e pranimit në shërbimin civil sipas Konkursit me numër protokolli 872, për pozitën "Kadet për Zyrtar Korrektues", në Qendrën Korrektuese në Dubravë sipas Referencës MD/SHKK/12/30.06.2023, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e nenit 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 4 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: "1. Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë. 2. Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuar në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore", si dhe nenin 34 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, me të cilin parashihet se: Themelimi i marrëdhënies së punës kadet për zyrtarë korrektues 1. Themelimi i marrëdhënies së punës për pozitën kadet për zyrtar korrektues në Shërbimin Korrektues bëhet në pajtim me parimin e meritës, aftësisë profesionale, transparencës së procesit, paanshmërisë, integritetin, mos-diskriminimit, mundësive të barabarta dhe të drejtën për t'u ankuar...3. SHKK ofron mundësi të njëjta punësimi të gjithë personave të interesuar pa dallim përkatësie etnike, gjinie, ngjyre, religjioni, bindje politike, me kusht që ata t'i përmbushin kriteret e përcaktuara në konkursin e shpallur.

Kështu që duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1322/2023

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesve:*
- *Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*